VENDIM
Nr. 35, datë 13.7.2016

PËR MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR NJË PROJEKT NË VAZHDIM, TË GRANTIT "ARSIMI", PROGRAMI I ZHVILLIMIT VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të financimit për vitin 2016, për një projekt në vazhdim, me cikël financimi 2015–2016, për grantin "Arsimi", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi i përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit, miratuar sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të saj, i shtohet portofolit të grantit "Arsimi", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond shpërndahet, brenda vitit 2016, për financimin e projekteve të reja dhe/ose në vazhdim të grantit të arsimit.

3. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Projekti me cikël financimi 2015–2016, i financuar përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financuar për vitin 2016 (lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (lekë)
	QARKU DURRËS						
1.	Bashkia Durrës	Ndërtim i shkollës "Bajram Curri", Durrës	119 376 062	96 564 458	29 980 000	33 292 229	33 292 229
	TOTALI		**119 376 062**	**96 564 458**	**29 980 000**	**33 292 229**	**33 292 229**

Shënim

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe shërben si referencë për përllogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2015.

2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

3. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e realizuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

4. "Vlera e financuar për vitin 2016" tregon vlerën e financimit, të alokuar deri më tani, me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. "Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016", tregon diferencën midis vlerës së kontratës dhe atë realizuar për vitin 2015 dhe të financuar deri më tani për vitin 2016 sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Për këtë projekt, vlera e mbetur e financimit për vitin 2016, përmbush detyrimin për financim, duke shlyer në masën 100% vlerën e kontratës për zbatimin e punimeve. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresë nr. 7091 prot., datë 12.7.2016.